



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E PODUJEVËS/OPŠTINA PODUJEVO/MUNICIPALITY OF PODUJEVA		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE		
Dërguar më Dostavljeno 03.02.2026		
Njesi.org. Org. jed.	Nr. Br.	Shtojcë - Prilog
02-016/01-0001-348/26		
PODUJEVË - PODUJEVO		



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva
Kompania regionale "Pastrimi"



Më datë:02.02.2026

MARRËVESHJE

E lidhur në mes:

Komunës së Podujevës më tej 'Komuna', me adresë në rrugën " Nuhi Gashi" në Podujevë, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës – z.Shpejtim Bulliqi

dhe

Kompanisë Rajonale për Mbeturina "Pastrimi" SH.A , më tej "Kompania" me adresë në rrugën "Tahir Zajmi" Nr.5 në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Kryeshefi Ekyekutiv, z.Petrit Reçica

Neni 1

Objekti i Kontratës

1. Pastrimi dhe mbledhja e mbeturinave e amvisërive dhe bizneseve nga rrugët, trotualet dhe hapsirat publike në qytetin e Podujevës dhe bartja e tyre deri në deponi.
2. Pastrimi(largimi) i mbeturinave nga deponitë e egra në qytet dhe fshatrat (amvisëritë dhe inerte).
3. Zbrazja e kontejnerit 7m³.

4. Largimi, transporti i shtazëve të ngordhura (lopë, buallica, kuaj) etj dhe varrosja e tyre në deponi duke i vendosur në najlon dhe mbuluar me gëlqere pluhur dhe më pas me dhe.
5. Largimi, transporti i shtazëve të ngordhura (qenë, dele, dhi) etj dhe varrosja e tyre në deponi duke i vendosur në najlon dhe mbuluar me gëlqere dhe më pas me dhe.
6. Pastrimi nga mbeturinat dhe roja e “Parkut të Paqes” të qytetit, sheshit, parkut mbrapa kafiterive, parkut mbrapa banesave, parkut te posta, parkut te QKMF-së dhe parkut te rruga “Ali Ajeti”.
7. Zbrazja e kontinierit 1m³.
8. Pastrimi dhe mbledhja e mbeturinave nga sheshi i qytetit, mirëmbajtja duhet të jetë 24 orë sipas nevojës.
9. Larja e sheshit.
10. Pastrimi i sheshit nga bora.
11. Shërbimi i debllokimit të kanaleve të kanalizimit apo të ngjashme përmes pajisjeve apo makinerive për debllokim.
12. Shërbimet nga paragrafi 1 i këtij neni do të bëhen me kërkesë nga AK dhe për të njëjtën do të pagujë shërbimin sipas punëve të kryera.

Neni 2

Përshkrimi i shërbimit

1. Kontraktori pajtohet të kryej shërbimin në fshirjen, larjen e rrugëve, trotuareve në qytetin e Podujevës dhe marrjen e mbeturinave në institucionet publike.
2. Palët kontraktuese arritën marrëveshje që për kontrollin dhe cilësinë e punës të caktojnë menaxherin dhe ekipin për zbatimin e kryerjes së shërbimit, gjithashtu palët kontraktuese bashkëarisht do të përcaktojnë lokacionet e deponive ilegale që duhet të eliminohen.
3. AK ka të drejtë që reklamimin për punën e kryer ta bëjë në afatin prej dy orëve pas përfundimit të punës, pas kalimit të këtij afati reklamimet nuk pranohen nga ana e kontraktuesit.
4. Kontraktuesi merr për obligim që reklamimet që i bënë AK ti menjanojë në afat prej 8 orëve.

5. AK ka të drejtë të përcjellë kryerjen e shërbimit dhe dy palët do të nënshkruajnë procesin mbi shërbimin e kryer sipas kërkesës së AK, në të kundërtën kontraktori do të llogarisë se punët janë të kryera edhe pa nënshkrim të procesit.
6. AK nuk mund të jap vërejtje për punët e pakontraktura.

Neni 2

Afati i kontratës

1. Kjo kontratë është vazhdueshmëri e marrëveshjeve paraprake të Komunës së Podujevës dhe KRM Pastrimi, e cila vlenë për periudhën 01 Janar 2025 deri më 31 dhjetor 2026.
2. Kontrata mund të vazhdohet me automatizëm nën të njëjtat kushte dhe periudhë kohore nëse nuk ka kërkesë paraprake së paku 30 ditë para skadimit të afatit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 3

Çmimi për shërbimet Komunale që do të ofron kontraktuesi

1. Pastrimi dhe mbledhja e mbeturinave nga rrugët, trotualet dhe hapsirat publike në qytetin e Podujevës dhe bartja e tyre deri në deponi, çmimi është 0.01€ me Tvsh për m².
2. Pastrimi (largimi) i mbeturinave nga deponitë e egra në qytet dhe fshatrat (amvisëritë dhe inerte), çmimi është 12.00€ me Tvsh për m³.
3. Zbrazja e kontejnerit 7m³ çmimi është 40.85€ me Tvsh për m³.
4. Largimi, transportimi i shtazëve të ngordhura (lopë, buallica, kuaj) etj dhe varrosja e tyre në deponi duke i vendosur në najlon dhe mbuluar me gëlqere pluhur dhe më pas me dhe, çmimi është 100.00€ me Tvsh për copë.
5. Largimi, transportimi i shtazëve të ngordhura (qenë, dele, dhi) etj dhe varrosja e tyre në deponi duke i vendosur në najlon dhe mbuluar me gëlqere pluhur dhe më pas me dhe, çmimi është 30.00€ me Tvsh për copë.
6. Pastrimi nga mbeturinat në parkun e qytetit, sheshit, parkut mrapa kafiterive, parkut mrapa banesave, parkut te posta dhe roja e "Parkut të Paqes", çmimi është 350.00€ me Tvsh për muaj.

7. Zbrazja e kontejnerit 1m³, çmimi është 10.52€ me Tvsh për copë.
8. Pastrimi dhe mbledhja e mbeturinave nga sheshi i qytetit, mirëmbajtja duhet të jetë 24orë sipas nevojës, çmimi është 0.04€ me Tvsh për m².
9. Larja e sheshit, çmimi është 0.9€ me Tvsh për m².
10. Pastrimi i sheshit nga bora, çmimi është 0.02€ me Tvsh për m².
11. Shërbimi i debllokimit të kanaleve të kanalizimit apo të ngjashme përmes pajisjeve apo makinerive për debllokim, çmimi është 2.00 € me Tvsh për m

Neni 4

Obligimet e palëve kontraktuese

1. Autoriteti merr për obligim që shumën e kalkuluar për punën e kryer nga kjo kontratë ta paguaj në afatin ligjor pas marrjes së faturës.
2. Për cdo vërejtje që konsiderohet në teren për moskryerjen e shërbimeve nga të gjitha pozicionet e cekura në kontratë AK është i obliguar ta informojë kryerësin e shërbimeve në afat prej 24 orëve në telefonat fiks 038/603-143, 603-411, 603-537, te personat kontraktues.
3. AK merr obligim të paguaj edhe tatimin në emër të Tvsh-së në vlerën e faturës sipas ligjit.
4. Kontraktori (OE) merr për obligim që në fillim të cdo muaji t'ia paraqes kontraktuesit faturën për muajin paraprak të cilin AK është i obliguar ta paguaj në afatin prej 8 ditësh.

Neni 5

Llogaritja e faturës

1. Fatura do të llogaritet sipas punës së kryer dhe specifikacionit të nënshkruar nga të dy palët kontraktuese dhe të njëjtës do ti bashkangjitet specifikacioni i cili do të dërgohet AK në fillim të cdo muaji për muajin paraprak.
2. AK është i obliguar që pagesën e faturës ta bëjë brenda 8 ditëve.

Neni 6

Ndërprerja e kontratës

1. Ndërprerja e kontratës me fajin e kontraktorit (OE), AK mund ta ndërpres kontratën në rast se kontraktori nuk është në gjendje të plotësoj parimet dhe kushtet e kësaj kontrate, AK duhet t'ia tërheqë vërejtjen me shkrim kontraktorit se ai nuk po i kryen punët sipas kontratës.
2. Ndërprerja e kontratës me fajin e AK-kontraktori (OE), sikurse AK ka të drejtë që të ndërpres kontratën e lidhur nëse AK nuk i kryen obligimet me kohë atëherë kontraktori nuk ka të drejtë të ndërpresë kontraktën pa paralajmërimin e AK.

Neni 7

Ndryshimi i kontratës me marrëveshje

Për ndryshimin e ndonjë pike të kësaj kontrate apo shpërbërje e saj palët kontraktuese duhet të njoftohen me shkrim së paku 30 ditë më herët.

Neni 8

Zgjidhjet e mosmarrëveshjeve

Në rast se vjen ndonjë mosmarrëveshje në mes të palëve kontraktuese, kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është Gjykata Themelore në Prishtinë.

Neni 9

Përpilimi i kontratës

Kontrata është e përpiluar në katër kopje origjinale ku secila palë kontraktuese do ti mbajë nga dy kopje.

KRM "Pastiri" SH.A

Petrit Reçica



Kryetari i Komunës

Shpejtim Bulliqi

